

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ROEL 2013” SH.P.K.

Sot, më date **01.02.2021**, une i nenshkruari:

- **Rapi Cela** lindur ne Berat me 13.09.1983 ,shtetas shqiptar, rezident ne Berat , identifikuar me karten e identitetit me Nr. **034247566** ,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**ROEL 2013**” **SH.P.K.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: “**ROEL 2013**” **SH.P.K**

Neni 2

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:- Berat, Samatic, Kutalli, rruga “Elmaz Dyli”, truall me sipërfaqje 1600 m2 me pasuri nr.16/41, e zone kadastrale nr.3256.

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *roelshpk@yahoo.com*
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- Prodhim , tregtim ambllazh kartoni dhe import-eksport fruta perime,,etj.

-Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **500 000** (peseqind mije) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Rapi Cela**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **500 000** leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakëve do të jetë në para .



Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithë ortaket jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statur.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqerisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqerisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përgjashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqerise.

Neni 9

Administrimi

Aministratori i shoqerise emerohet Z. **Rapi Cela** lindur ne Berat me 13.09.1983 ,shtetas shqiptar, rezident ne Berat , identifikuar me karten e identitetit me Nr. **034247566** ,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të percaktuara qartë në statutin e shoqërisë.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përbastimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezulttit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të percaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i Ndryshuar.

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISE

Rapi Cela

Rapi Cela
